



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 232, datë 16.09.2022

PËR

**“RILLOGARITJEN E PAGAVE PËR ANËTARËT DHE ISH-ANËTARËT E KLP-SË,  
PËR PERIUdhËN 01.01.2019 – 28.05.2021”**

Bazuar në nenin 102, pika 2 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, nenin 12, pika 2, shkronja “c”, pika 3 dhe pika 5 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nenin 12 pika 5 të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, VKM-në Nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr.351, datë 27.07.2022, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Rillogaritjen e pagave për anëtarët dhe ish-anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për periudhën 01.01.2019 – 28.05.2021.
2. Në zbatim të këtij Vendimi, ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore të KLP-së të bëjë rillogaritjet dhe pagesat për secilin prej anëtarëve dhe ish anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në raport me kohëzgjatjen e mandatit të tyre në KLP.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot me datë 16.09.2022.

KRYETARI

Alfred Balla

